

RAPORT-PËRFUNDIMTAR-AUDITIMI

Mbi

“Vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, i riskut dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësime, në arritjen e objektivave”.

Data e përgatitjes së Raportit Përfundimtar : 19.12.2017

Auditimi është kryer në bazë të programit të auditimit, të miratuar nga Ministri i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit nr.10308/1 datë 13.10.2017

Auditimi është kryer nga:

- Merita Tërshana
- Vjollca Haxhiu
- Jeton Shehu

Objekti: Vlerësimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm, i riskut dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësime, në arritjen e objektivave

Subjekti i auditimit: Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë.

Periudha e audituar: 01.12.2015 deri më 30.09.2017

Auditimi ka filluar më: 16.10.2017

Auditimi ka përfunduar: 31.10.2017

Projekt raporti i auditimit mbahet me:

- Znj. Dhurata Bozo, në cilësinë e Drejtoreshës së institucionit.
- Znj. Pranvera Dingo, në cilësinë e përgjegjëses së Sektorit të Shërbimeve Publike.
- Znj. Pranvera Disha, në cilësinë e specialistit të Sektorit të Shërbimeve Publike.
- Ndarja e pikave të programit:

Merita Tërshana :

- Pika nr. 2
- Pika nr.3
- Pika nr.4

Vjollca Haxhiu:

- Pika nr.5
- Pika nr.6

Jeton Shehu

-Pika nr. 1

Metodat e auditimit:

Nga ana e misionit të angazhimit janë kryer “testet e drejtpërdrejta”, “testet e kontrollit”, sondazhet, intervista si dhe studimi i raporteve të ndryshme.

Metodologjia e ndjekur:

Nr.	Përmbajtja e raportit	Faqe
I-	Përmbledhje Ekzekutive	2
II-	Çështjet e trajtuara:	
1.	Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme	2
2.	Auditim, mbi sistemin e drejtimit, strukturën organizative dhe zbatimin e procedurave ligjore në llogaritjen dhe shpërndarjen e pagave	3



3.	Auditim, mbi zbatimin e ligjshmërisë për hartimin e zbatimit e buxhetit, kryerjen e veprimeve me thesarin	5
4.	Auditim, mbi prokurimin e fondeve publike dhe blerjet	14
5.	Auditim mbi organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit	15
6.	Auditim mbi hartimin dhe zbatimin e gjurmëve specifike të auditit	15

Përmbledhje ekzekutive:

Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë është krijuar me VKM Nr.303 datë 01.07.1999 “Për krijimin e Sistemit të Akreditimit në Arsimin e Lartë”, i ndryshuar, VKM Nr.424 datë 02.06.2010 “Për miratimin e rregullores për sistemin e akreditimit, organizimin dhe veprimtarinë e institucioneve të sigurimit të jashtëm të cilësisë”, i ndryshuar.

Me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.109 datë 15.02.2017 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë e të Bordit të Akreditimit dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë”, pika 1, Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë riorganizohet në Agjencinë e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL).

Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL) është i vetmi institucion që kontrollon dhe vlerëson cilësinë në arsimin e lartë. Kjo, duke u mbështetur në standardet shtetërore të cilësisë dhe në standardet dhe udhëzimet përkatëse të cilësisë në Hapësirën Evropiane dhe atë ndërkombëtare të arsimit të lartë. ASCAL është institucion i pavarur, i paanshëm dhe transparent në kryerjen e veprimtarisë së tij. ASCAL kryen vlerësimin paraprak të cilësisë për IAL-t, njësitë e tyre dhe programet e studimit të tre cikleve në kuadër të licencimit të tyre si dhe vlerësimin e jashtëm në kuadër të akreditimit institucional dhe të programeve të studimit. Gjithashtu Agjencia kryen vlerësime analitike dhe krahasuese për IAL, programet dhe fushat e studimit.

Misioni i ASCAL

- Sigurimi i cilësisë në arsimin e lartë përmes vlerësimit të jashtëm, objektiv dhe të pavarur;
- Ruajtja e standardeve të cilësisë;
- Promovimi dhe përmirësimi i cilësisë së institucioneve të arsimit të lartë e të programeve të studimit që ato ofrojnë.

Për të përmbushur misionin e tij ASCAL përveç akteve ligjore në fuqi mbështetet edhe në Kodin e Cilësisë si dhe në rregulloret e brendshme të tij.

Objektivi kryesor është përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë në arsimin e lartë në Shqipëri.

Në zbatim të programit të auditimit nr. 10308 prot, datë 13.10.2017, të miratuar nga Ministri i Arsimit dhe Sportit, Drejtoria e Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, auditori veprimtarinë e plotë në bazë sistemi të aktivitetit Agjencisë së sigurimit të cilësisë në Arsimin e Lartë, sipas drejtimeve të programit të miratuar.



Në këtë auditim, jemi fokusuar në zbatimin e ligjshmërisë e rregullshmërisë dhe vlerësimin e veprimtarisë administrative e ekonomiko-financiare, për periudhën 01.12.2015 deri më 30.09.2017

Opinionin e auditimit konsiston se: Pasqyrat financiare për vitin 2015, 2016 dhe 9 mujori 2017 japin një pamje reale dhe të saktë të gjendjes së aktiveve të institucionit në mbyllje të ushtrimit, e për rrjedhojë i ofrojnë ndihmë menaxherit në marrjen e masave për arritjen e objektivave.

Entiteti i audituar, ka realizuar planin e buxhetit për vitin 2015 në masën 74% si dhe për vitin 2016 në masën 77 % ndërsa për periudhën janar – shtator 2017 në masën 62%, që tregon menaxhim efektiv dhe eficientë të fondeve buxhetore të vëna në dispozicion.

Për periudhën objekt auditimi rezulton se, sistemet e kontrollit të brendshëm kanë funksionuar mirë, duke garantuar zbatimin e objektivave dhe politikave menaxheriale, nëpërmjet procedurave që kanë inkurajuar efikasitetin operativ, përputhjen me ligjet dhe rregulloret, mbrojtjen e aktiveve nga vjedhja e shpërdorimi, prodhimin e të dhënave të sakta dhe të besueshme kontabël. Raporti Përfundimtar mbahet mbi bazën e auditimit të kryer, për dokumentacionin e disponuar dhe paraqitur nga subjekti si dhe shqyrtimin e shpjegimeve të punonjësve të subjektit, sipas çështjeve të programit të miratuar:

II. ÇËSHTJET E TRAJTUARA:

1-Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme:

Auditimi i fundit është kryer nga Auditimi Brendshëm MAS sipas Programit të auditimit nr 8891/1, datë 19.11.2015.

Në përfundim të auditimit me shkresën nr. 1075, prot, datë 05.02.2016, është dërguar raporti final sipas të cilit nuk janë lënë rekomandime.

2- Auditim mbi sistemin e drejtimit, strukturën organizative dhe zbatimin e procedurave ligjore në llogaritjen dhe shpërndarjen e pagave.

Struktura organizative e APAAL është sipas Urdhrit të Kryeministrit Nr.171 datë 27.09.2010 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë së Akreditimit të Arsimit të Lartë dhe ka 3 sektorë me një staf prej 15 punonjësish.

Drejtori i Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e lartë është emëruar me Urdhrin e Kryeministrit Nr. 44 datë 11.04.2017 “Për emërimin në detyrë të Drejtorit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë”.

Punonjësi me kontratë të përkohshme “sanitare”:

Për vitin 2015

Është proceduar në mbështetje të shkresës së MAS Nr.293/1 datë 30.01.2015 “Konfirmohet 1 (një) sanitare me kontratë të përkohshme për vitin 2015” sipas VKM Nr.11 datë 14.01.2015 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2015, në njësitë e qeverisjes qendrore”

Për vitin 2016



Është proceduar në mbështetje të shkresës së MAS Nr.2161/1 datë 16.03.2016 “Dërgohet shkresa e Ministrisë së Financave Nr.18154/53 datë 01.03.2016” sanitare 4/orë në ditë sipas tabelës bashkëlidhur shkresës.

Për vitin 2017

Me shkresën e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit Nr. 245/1 datë 31.01.2017 “Dërgohet për zbatim VKM Nr.7 datë 11.01.2017 “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme për vitin 2017, në njësitë e qeverisjes qendrore”, sanitare 4 orë/ditë, sipas tabelës më poshtë:

Pagat e sigurimet shoqërore

Vlerësuam sistemin e pagesave nëpërmjet listë pagesave dhe evidentuam se hartimi i tyre është në përputhje me legjislacionin në fuqi, me procedurat dhe politikën e menaxhimit

Sipas listë pagesave pagat dhe shtesat mbi pagë janë llogaritur sipas klasave përkatëse për çdo kategori punonjësish në përputhje me VKM Nr.545 datë 11.08.2011 “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në Kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, Administratën e Presidentit, Kuvendit, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Prokurorinë e Përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të KM/Kryeministrit në institucionet në varësi të ministrive të linjës dhe administratën e Prefektit”, i ndryshuar; VKM Nr.187 datë 08.03.2017 “Për miratimin e strukturës dhe nivelit të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve në Kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e Presidentit, Kuvendit, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Gjykatën e Lartë, Prokurorinë e Përgjithshme, disa institucioneve të pavarura, në institucione në varësi të Kryeministrit , institucione në varësi të ministrive të linjës dhe administratës së Prefektit”, VKM Nr.717 datë 23.06.2009 “Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore” i ndryshuar.

Listë pagesa e pagave është konform Udhëzimit Nr.4 datë 13.12.2016 të Ministrit të Financave dhe Ministër Shteti për Inovacionin dhe Administratën Publike “Për formën, elementët dhe plotësimin e borderosë së pagave për njësite e qeverisjes së përgjithshme”. Mbas çdo listë pagese bashkëlidhur ndodhet edhe listë prezenca mujore.

Llogaritja e sigurimeve shoqërore është bërë sipas VKM Nr.77 datë 28.01.2015 “Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistem i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor”, VKM Nr.399 datë 03.05.2017 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”. Llogaritja e tatimit mbi të ardhurat personale është bërë sipas Ligjit Nr.8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar. Derdhja e tyre është bërë në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

Kontabilizimi i kontributit për sigurimet shoqërore dhe tatimit mbi të ardhurat është kryer sipas Planit Unik Kontabël. Llogaria 421 “Paga personeli” është kuadruar me listë pagesat mujore të personelit.

Dietat

Praktikat dokumentare për pagesën e dietave dhe udhëtimit brenda vendit, rezultoi se janë bërë sipas kërkesave të VKM Nr.997 datë 12.10.2010 Për



trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendbanimit të tyre”.

3-Auditim, mbi zbatimin e ligjshmërisë për hartimin dhe zbatimin e buxhetit, kryerjen e veprimeve me thesarit.

Sipas dokumentacionit të audituar rezulton se për zbatimin e buxhetit të shtetit është vepruar në mbështetje të Ligjit Nr.9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”

Sipas detaji mit të buxhetit dhe limiti mujor të lejuar të shpenzimeve është bërë realizimi në tituj, kapituj dhe llogari ekonomike.

Sektori i Shërbimeve dhe Publikimit ka hartuar evidencat mujore progresive për shpenzimet e kryera, mbi bazën e të cilave janë bërë akordimet për buxhetin e miratuar, me Degën e Thesarit Tiranë. Ndjekja e treguesve ekonomiko-financiare është bërë nëpërmjet regjistrimit dhe evidentimit në librat përkatës si dhe raportimit të tyre në organet drejtuese dhe Degës së Thesarit Tiranë.

Urdhërpagesat janë të plotësuara sipas formularit standard të miratuar për këtë qëllim. Urdhërpagesat janë të firmosura dhe të vulosura nga Dega e Thesarit Tiranë, dhe veprimet janë të kontabilizuara sipas rregullave të kontabilitetit.

a-Realizimi i buxhetit për periudhën Dhjetor 2015- shtator 2017

Viti 2015

Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, për vitin buxhetor 2015, ka kryer aktivitetin financiar në mbështetje të ligjit Nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, Ligji 160/2014 “Për buxhetin e vitit 2015”, Udhëzimit Nr.2 datë 06.02.2012 të Ministrit të Financave “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, të ndryshuar, shkresat e Ministrisë së Financave Nr. 18082/82, datë 07.01.2015 “Mbi detajimin e shpenzimeve për vitin 2015”.

Në tabelën e mëposhtme është realizimi i buxhetit sipas Shkresës së MAS Nr.9662/3 datë 12.01.2015 “Dërgohet buxheti i detajuar për vitin 2015”.

APAAL ka në buxhetin e saj vjetor rreth 22.616.389 lekë, fonde sipas zërave (paga art.600; sigurimet shoqërore art. 601; shpenzime operative, art. 602

Nr	Emërtimi	Llogaria ekonomike	Plani, vlera në lekë	Plani i rishikuar i buxhetit	Fakti vlera në lekë	Realizimi në përqindje
1	Paga	6000000	14.667.000	14.667.000	11.788.250	80.37
2	Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	6010000	2.449.389	2.449.389	1.935.036	79.00
3	Shpenzime operative	6020000	5.500.000	5.500.000	3.073.211	55.87
			22.616.389	22.616.389	16.796.497	74



Realizimi i buxhetit për vitin ushtrimor 2015 është 74% duke ndikuar në mosrealizimin e tij artikulli 602 "Shpenzime operative" të realizuar në vlerën 55.8%.

Viti 2016

Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, sipas buxhetit të vitit 2016, kryen aktivitetin financiar në mbështetje të ligjit Nr. 9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH", Ligji 147/2015 "Për buxhetin e vitit 2015", Udhëzimit Nr.2 datë 06.02.2012 të Ministrit të Financave "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", të ndryshuar, shkresat e Ministrisë së Financave Nr. 17761/84, datë 07.01.2016 "Dërgohet detaji mi i shpenzimeve koherente për vitin 2016".

Për vitin ushtrimor 2016, APAAL ka në buxhetin e saj vjetor rreth 22.900.000 lekë, fonde sipas zërave (paga art.600; sigurimet shoqërore art. 601; shpenzime operative, art. 602.

Nr.	Emërtimi	Llogaria ekonomike	Plani, vlera në lekë	Plani i rishikuar i buxhetit	Fakti vlera në lekë	Realizimi në përqindje
1	Paga	6000000	15.000.000	15.000.000	12.622.922	84.15
2	Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	6010000	2.400.000	2.400.000	2.027.849	84.49
3	Shpenzime operative	6020000	5.500.000	5.500.000	2.987.027	54.30
			22.900.000	22.900.000	17.637.798	77

Për vitin ushtrimor 2016 buxheti është realizuar në vlerën 77% ka ndikuar në mosrealizimin e tij artikulli 602 "Shpenzime operative të realizuar në vlerën 54.3%.

1. Viti janar - shtator 2017

Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL), sipas buxhetit të vitit 2017, kryen aktivitetin e vet financiar. APAAL, në mbështetje të ligjit Nr. 9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH", Ligji 130/2016 "Për buxhetin e vitit 2017", Udhëzimit Nr.2 datë 06.02.2012 të Ministrit të Financave "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", të ndryshuar, shkresat e Ministrisë së Financave Nr. 17911/68, datë 10.01.2017 "Dërgohet detajimi i shpenzimeve koherente për vitin 2017".

ASCAL ka në buxhetin e saj vjetor rreth 20.900.000 lekë, fonde sipas zërave (paga art.600; sigurimet shoqërore art. 601; shpenzime operative, art. 602

Nr.	Emërtimi	Llogaria ekonomike	Plani, vlera në lekë	Plani i rishikuar i buxhetit	Fakti vlera në lekë (9 muaj)	Realizimi në përqindje
1	Paga	6000000	15.000.000	15.000.000	9.761.870	
2	Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	6010000	2.200.000	2.400.000	1.564.659	



3	Shpenzime operative	6020000	3.500.000	3.500.000	1.786.444	
	SHUMA		20.700.000	20.900.000	13.112.973	

Ambientet e punës së APAAL/ASCAL janë jo në parametrat optimal për kryerjen e funksioneve të saj, kjo për faktin se në 6 vitet e fundit (2012-2017) nuk është siguruar fond për investime për përmirësimin e kushteve të punës me gjithë kërkesat e vazhdueshme të saj.

Krijimi dhe përdorimi i të ardhurave

Të ardhurat që realizon entiteti mbështeten në Udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr.29/1 datë 16.08.2011 “Për përcaktimin e tarifave të shërbimeve që kryen Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë”, i ndryshuar.

Të gjitha ardhurat e realizuara janë kryer sipas Urdhrit të Ministrit të Financave Nr.95 datë 11.11.2009 “Për miratimin e faturës për arkëtim”.

Në këtë faturë përfshihen:

-Vlerësimin që do kryejë APAAL sipas kërkesës që ka bërë institucioni i arsimit të lartë

-Tarifat për çdo vlerësim.

Institucionit të arsimit të lartë i është dërguar shkresa për vlerësimin që do të kryejë APAAL së bashku me faturë arkëtimin. Tarifa për çdo shërbim është arkëtuar para fillimit të procesit të vlerësimit në APAAL pranë bankave të nivelit të dytë për Degën e Thesarit Tiranë, për llogari të Agjencisë Publike të Akreditimit të Arsimit të Lartë.

Në dokumentacionin e të ardhurave u evidentua se në çdo faturë arkëtimi u gjet shkresa e APAAL-it për pagesën në bankë ose në Degën e Thesarit.

Çdo muaj për arkëtimet e APAAL bëhet akt akordimi me Degën e Thesarit Tiranë. Ky akt akordim është nënshkruar nga punonjësja e Degës së Thesarit dhe Përgjegjësjë e Sektorit të Shërbimeve dhe Publikimit dhe specialistja e financës së APAAL.

Në dokumentacionin arkëtimeve bashkëngjitur u gjetën :

- 1.Pagesën e bankës ose të Degës së Thesarit
- 2.Aktrakordimi i Degës së Thesarit Tiranës
- 3.Tabelë përmbledhëse ku për çdo arkëtim citohet:

-Institucioni i arsimit të lartë

-Vlerësimet që ka kryer APAAL

-Vlera e arkëtimin.

Të ardhurat e arkëtuara nga shërbimet e realizuara nga Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë derdhen 10% në buxhetin e shtetit dhe 90% në buxhetin e Agjencisë.

Pjesa e të ardhurave e Agjencisë së Akreditimit të Arsimit të Lartë, evidentohet, autorizohet dhe përdoret me strukturë të veçante buxhetore kapitulli 6, “Të ardhura jashtë limitit”

Sipas VKM Nr.424 datë 02.06.2010 “Për miratimin e rregullores për sistemin e akreditimit, organizimin dhe veprimtarinë e institucioneve të sigurimit të jashtëm të cilësisë” i ndryshuar me VKM 141 datë 18.02.2015 , pika 5, “Të



ardhurat për shërbimet e kryera nga Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë transferohen nga një vit financiar në tjetrin, vetëm për vlerën që derdhet në buxhetin e Agjencisë, përfshirë të ardhurat e krijuara deri në vitin 2014.”

Sipas Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr.29/1 datë 16.08.2011 “Për përcaktimin e tarifave të shërbimeve që kryen Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë”, i ndryshuar.

Këto të ardhura janë përdorur për :

1-Për pagesat e ekspertëve të jashtëm, vendas ose të huaj dhe konsulentëve, të cilët janë kontraktuar nga APAAL;

2-Për të mbuluar shpenzimet operative dhe të funksionimit të Këshillit të Akreditimit

3-Për pagesën e anëtarëve të Këshillit të Akreditimit dhe shpenzime të tjera të tij

4-Për pagesën e tarifave të anëtarësimit në organizata ose institucione ndërkombëtare

Për vitin 2015

APAAL bazuar në VKM 424 datë 02.06.2010 “Për miratimin e rregullores për sistemin e akreditimit, organizimin dhe veprimtarinë e institucioneve të sigurimit të jashtëm të cilësisë”, i ndryshuar dhe në Udhëzimin nr. 29/1, datë 16.08.2011 “Për përcaktimin e tarifave të shërbimeve që kryen Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë”, i ndryshuar, nga të ardhurat e trashëguara, në fillim të vitit 2015 ka në buxhetin e saj 178.603.998 lekë, dhe përdorimi i tyre është sipas tabelës së mëposhtme:

Shpenzimet operative llogaria ekonomik602		
	Gjendja e trashëguar e fondeve 01 janar 2015	Shpenzime faktike
Shpenzime operative Gjithsej	177.582.635	18.844.444
Shpenzime për honorarë për Këshillin e Akreditimit (të huaj dhe vendas)		3.048.428
Shpenzime për honorarë për ekspertet (të huaj dhe vendas)		10.635.750
Shpenzime udhëtim e dieta jashtë vendit të punonjësve të APAAL, të ekspertëve të huaj, anëtarëve të KA të huaj		4.995.742
Komisione bankare		59.219
Shpenzime të ndryshme qeras salle etj.		50.460
Shpenzime për funksionin e Këshillit të Akreditimit		54.845
Shpenzimet operative llogaria ekonomike 605		
	Gjendja e trashëguar e fondeve 01 janar 2015	Shpenzime faktike
Shpenzime operative Gjithsej	1.021.363	500.156
Shpenzime për tarifën e anëtarësimit në organizatat ndërkombëtare (ENQA, CEENQA, INQAAHE)		500.156



Për vitin 2016

APAAL bazuar në VKM 424 datë 02.06.2010 "Për miratimin e rregullores për sistemin e akreditimit, organizimin dhe veprimtarinë e institucioneve të sigurimit të jashtëm të cilësisë", i ndryshuar dhe në Udhëzimin nr. 29/1, datë 16.08.2011 "Për përcaktimin e tarifave të shërbimeve që kryen Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë", i ndryshuar, nga të ardhurat e trashëguara, në fillim të vitit 2016 ka në buxhetin e saj 181.491.558 lekë dhe përdorimi i tyre është sipas tabelës së mëposhtme.

Shpenzimet operative llogaria ekonomike 602		
	Gjendja e trashëguar e fondeve 01 janar 2016	Shpenzime faktike
Shpenzime operative Gjithsej	180.470.351	60.973.475
Shpenzime për honorarë për Këshillin e Akreditimit (të huaj dhe vendas)		3.620.896
Shpenzime për honorarë për ekspertët (të huaj dhe vendas)		13.712.865
Pagesa sipas faturave të QAA në zbatim të kontratës Nr.2064 datë 29.02.2016 ndemjes MAS dhe QAA)		35.152.880
Shpenzime udhëtim e dieta jashtë vendit të punonjësve të APAAL, të ekspertëve të huaj, anëtarëve të KA të huaj		6.238.127
Shpenzime udhëtim e dieta për ekspertët e QAA (Sipas kontratës Nr.2064 datë 29.02.2016 ndërmjet MAS dhe QAA)		1.942.020
Komisione bankare		155.927
Shpenzime të ndryshme qira salle etj.		127.940
Shpenzime për funksionin e Këshillit të Akreditimit		22.820
Shpenzimet operative llogaria ekonomike 605		
	Gjendja e trashëguar e fondeve 01 janar 2016	Shpenzime faktike
Shpenzime operative Gjithsej	1.021.207	495.464
Shpenzime për tarifat e anëtarësimit në organizatat ndërkombëtare (ENQA, CEENQA, INQAAHE)		495.464



Mbështetur në ligjin Nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe VKM Nr.424 datë 02.06.2010 "Për miratimin e rregullores për sistemin e akreditimit, organizimin dhe veprimtarinë e institucioneve të sigurimit të jashtëm të cilësisë", të ndryshuar, Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë është institucioni publik përgjegjës si e vetme ose në bashkëpunim me agjenci të huaja, për vlerësimin e cilësisë për të gjitha institucionet e arsimit të lartë në Shqipëri dhe programet e studimit që ato ofrojnë.

Mbështetur në shkresën e MAS Nr.2064/1 datë 29.02.2016 "Lidhur me zbatimin dhe ekzekutimin e Kontratës së Përgjithshme të Projektit ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit (MAS) dhe Quality Assurance Agency for Higher Education (QAA-UK) Nr.2064 prot. datë 29.02.2016, MAS ngarkon APAAL ristrukturuar në ASCAL të ndjekë dhe të zbatojë kontratën e mësipërme duke ndjekur proceset e vlerësimit për akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë dhe kryerjen e pagesave përkatëse në përputhje me detyrat dhe përgjegjësitë e parashikuara në Kontratën e Përgjithshme.

Gjithsej 254.100 Euro

B. PAGESA E EKSPERTËVE VENDAS DHE TË HUAJ

Ekspertët vendas që janë angazhuar në kuadrin e vlerësimit paraprak të programeve të studimit dhe vlerësimit të jashtëm në kuadër të akreditimit janë miratuar nga Këshilli i Akreditimit mbi bazën e Urdhrit të lëshuar nga Drejtori i Institucionit. Ekspertët kanë nënshkruar kontratën me kushtet përkatëse. Pagesat e tyre bëhen me transfertë në llogaritë e tyre pranë bankave të nivelit të dytë. Gjatë kontrollit u vu re përshkrimi i punës në kontratë dhe pagesa ishte e njëjtë me listë pagesën që i jepej ekspertit.

Pagesës së ekspertit sipas Udhëzimit Nr.5 datë 30.01.2006 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, pika 2.3 "Të ardhura të tatueshme", pika 2.3.1/a i mbahet tatimi në burim.

Për vitin ushtrimor 2016 janë paguar gjithsej 68 ekspertë vendas me vlerë totale 7.707.000 lekë dhe 12 ekspertë të huaj në vlerën totale gjithsej prej 4.620.000 lekë.

PAGESAT PËR ANTARËSIMIN NË RRJETET NDËRKOMBËTARE

APAAL/ASCAL është pjesë e hapësirës evropiane të sigurimit të cilësisë duke bashkëpunuar më të gjithë aktorët e kësaj fushe dhe duke qenë anëtar i asociuar i ENQA, anëtar me të drejta të plota i CEENQA, anëtar me të drejta të plota i INQAAHE.

Pagesat për vitin 2016

Nr.	Emërtimi	Shuma në USD	Shuma në Euro
1	Pagesë INQAAHE (690.65 USD)	690.65	
	Shuma	690.65	



1	Pagesë CEENQA		600
	Shuma		600
1	Pagesë ENQA		2317
	Shuma		2317

Për vitin 2017

APAAL bazuar në VKM 424 datë 02.06.2010 "Për miratimin e rregullores për sistemin e akreditimit, organizimin dhe veprimtarinë e institucioneve të sigurimit të jashtëm të cilësisë", i ndryshuar dhe në Udhëzimin nr. 29/1, datë 16.08.2011 "Për përcaktimin e tarifave të shërbimeve që kryen Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë", i ndryshuar, nga të ardhurat e trashëguara, në fillim të vitit 2017 ka në buxhetin e saj 120.022.619 lekë dhe përdorimi i tyre është sipas tabelës së mëposhtme.

Shpenzimet operative llogaria ekonomike 602		
	Gjendja e trashëguar e fondeve 01 janar 2017	Shpenzime faktike deri më 30.09.2017
Shpenzime operative Gjithsej	119.496.876	62.182.321
Shpenzime për honorarë për Bordin e Akreditimit (të huaj dhe vendas)		2.542.932
Shpenzime për honorarë për ekspertët (të huaj dhe vendas)		5.352.470
Shpenzime për honorarë ekspertët vendas të parashikuar sipas të kontratës Nr.2064 datë 29.02.2016 ndërmjet MAS dhe QAA		2.271.500
Pagesa sipas faturave të QAA në zbatim të kontratës Nr.2064 datë 29.02.2016 ndërmjet MAS dhe QAA)		44.844.240
Shpenzime udhëtim e dieta jashtë vendit të punonjësve të APAAL, të ekspertëve të huaj, anëtarëve të BA të huaj		2.103.340
Shpenzime udhëtim e dieta për ekspertët e QAA (Sipas kontratës Nr.2064 datë 29.02.2016 ndërmjet MAS dhe QAA)		4.799.368
Komisione bankare		119.495



Shpenzime te ndryshme qira salle etj.		133.422
Shpenzime për funksionin e Këshillit të Akreditimit		15.554
Shpenzimet operative llogaria ekonomike 605		
	Gjendja e trashëguar e fondeve 01 janar 2017	Shpenzime faktike
Shpenzime operative Gjithsej	525.743	485.806
Shpenzime për tarifat e anëtarësimit në organizatat ndërkombëtare (ENQA, CEENQA, INQAAHE)		485.806

A. ZBATIMI I KONTRATËS NR.2064 PROT. DATË 29.02.2016 SË MAS DHE QAA-UK

Mbështetur në shkresën e MAS Nr.2064/1 datë 29.02.2016 "Lidhur me zbatimin dhe ekzekutimin e Kontratës së Përgjithshme të Projektit ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit (MAS) dhe Quality Assurance Agency for Higher Education (QAA-UK) Nr.2064 prot. datë 29.02.2016, MAS, **për periudhën janar-shtator 2017 është bërë pagesa prej 330.400 Euro.**

Në zbatim të shkresës e MAS Nr.2064/1 datë 29.02.2016 "Lidhur me zbatimin dhe ekzekutimin e Kontratës së Përgjithshme të Projektit ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit (MAS) dhe Quality Assurance Agency for Higher Education (QAA-UK) Nr.2064 prot. datë 29.02.2016, MAS, krahas ekspertëve të huaj janë aktivizuar edhe ekspertë vendas. Deri më 30 shtator pagesa e tyre është si më poshtë:

PAGESA E EKSPERTËVE VENDAS QË U AKTIVIZUAN NË VLERËSIMIN E JASHTËM TË INSTITUCIONEVE NË ARSIMIT TË LARTË, NË ZBATIM TË KONTRATËS Nr.2064/1 DATË 29.02.2016 MIDIS MAS DHE QAA NE GRUPIMET II, III, DHE IV JANË SI MË POSHTË :

Nr.	Emri e mbiemri	Pagesa bruto
1	Thoma Korini	350,000
2	Anila Hoda	150,000
3	Rajmonda Duka	350,000
4	Eglantina Hysa	350,000
5	Gjergj Thomai	470,000
6	Ana Kapaj	270,000
7	Sherif Bundo	420,000
		2,360,000

Në procesin e vlerësimit për akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë në Shqipëri (IAL), proces që u zhvillua në bashkëpunim me Agjencinë për



Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (QAA) në Mbretërinë e Bashkuar, janë kryer pagesat për shpenzimet e udhëtimit dhe qëndrimit të tyre.

B. Bordi i Akreditimit

Në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.109 datë 15.02.2017 "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë e të Bordit të Akreditimit dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë", pranë ASCAL ngrihet dhe funksionon Bordi i Akreditimit, si organ kolegjal vendimmarrës dhe i pavarur në veprimtarinë e tij.

Për anëtarët e Bordit të Akreditimit (të huaj dhe vendas) për vitin 2017 janë bërë pagesat duke u mbështetur Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.109 datë 15.02.2017 "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë e të Bordit të Akreditimit dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë", pika 27, ku masa e shpërblimit për çdo mbledhje për anëtarët vendas është 30.000 lekë, anëtarëve të huaj 1200 euro dhe kryetarit 30 për qind më shumë se anëtarët e huaj. Kryetarit dhe anëtarëve të huaj të bordit i mbulohen shpenzimet e udhëtimit dhe akomodimit në Shqipëri.

Bordi i Akreditimit është krijuar me Urdhrin Kryeministrit Nr.32 datë 17.03.2017 "Për emërimin e kryetarit dhe të anëtarëve të Bordit të Akreditimit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë".

Pagesat për çdo mbledhje janë bërë sipas Urdhrit të Drejtorit të Institucionit. Pagesës së anëtarëve (vendas dhe të huaj) të Bordit të Akreditimit sipas Udhëzimit Nr.5 datë 30.01.2006 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, pika 2.3 "Të ardhura të tatueshme", pika 2.3.1/a i mbahet tatimi në burim. Pagesat gjithsej për anëtarët vendas të bordit të akreditimit janë në vlerën 1110000 lekë.

Pagesa për anëtarët e huaj të bordit është në vlerën 959 546 lekë.

C. SHPENZIMET E ASCAL-IT PËR VEPRIMTARITË JASHTË VENDIT

Për periudhën që auditohet, praktikat dokumentare për pagesën e shpenzimeve të udhëtimit dhe dietat jashtë vendit për punonjësit e APAAL rezultojnë se janë bërë sipas kërkesave të VKM nr.870 datë 14.10.2011 "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit" dhe Udhëzimit Nr.22 datë 10.07.2013 të Ministrit të Financave "Mbi zbatimin e VKM Nr. 870 datë 14.10.2011 "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit", si dhe miratimin nga Ministria e Arsimit dhe Sportit për çdo aktivitet.

Sipas dokumentacionit të audituar rezultojnë arkëtime nga institucionet e arsimit të lartë për vitin 2015 gjithsej 31 145 400 lekë, për vitin 2016 gjithsej 24 702 400 lekë dhe për vitin 2017 gjithsej 44 400 716 lekë.

Sipas VKM Nr.109 datë 15.02.2017 "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë e të Bordit të Akreditimit dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë", rezultojnë edhe tarifa për shërbime të tjera si për :

- Tarifa për vërtetime dhe informacione. 7.600 lekë.
- Tarifa për shqyrtimin e aplikimit për vlerësim 69.000 lekë.



**DINAMIKA E TE ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE PER PERIUDHEN
2015- SHTATOR 2017**

Nr.	viti	Të ardhura të trashëguara nga viti paraardhës	Të ardhura që i takojnë institucionit	Gjithsej të ardhura	Shpenzime	Të ardhura të trashëguara vitin pasardhës
1	2015	150.573.138	28.030.860	178.603.998	19.344.600	159.259.398
2	2016	159.259.398	22.232.160	181.491.558	61.468.939	120.022.619
3	2017	120.022.619		120.022.619	62.668.127	57.354.492
	Janar-shtator 2017		40.083.584			

Në të ardhurat e vitit 2017 nuk janë bërë rritje të autorizuar.

Të ardhurat e trashëguara për vitet 2015 dhe 2016 janë pasqyruar në pasqyrat financiare në llogarinë ekonomike 520 "Disponlitete në Thesar"

4- Auditim mbi prokurimin e fondeve publike dhe blerjet.

Sipas dokumentacionit të audituar rezulton sa më poshtë vijon :

Me urdhërat e Drejtuesit të APAAL Nr.148 datë 31.12.2015 dhe Nr.127 datë 26.12.2016, është ngritur Komisioni i blerjeve, i cili ka funksionuar gjatë periudhave ushtrimore janar-dhjetor 2016 dhe janar-dhjetor 2017.

Sipas regjistrimit të prokurimeve publike të APAAL, janë evidentuar se procedurat për blerje mallrash dhe shërbimesh me vlera të vogla, janë bërë nëpërmjet sistemit elektronik të Agjencisë së Prokurimit Publik kryer nga Komisioni për blerjet e vogla. Procedurat e prokurimit janë kryer sipas ligjit Nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, VKM Nr.1 datë 10.01.2007 "Për rregullat e Prokurimit Publik", i ndryshuar, udhëzimit të Agjencisë së Prokurimit Publik Nr.7 datë 20.12.2012 "Për zhvillimin e prokurimeve me vlerë të vogël në sistemin e prokurimit elektronik për autoritetet kontrakturë dhe operatorët ekonomikë".

5- Auditim i sistemit të kontabilitetit financiar

Në zbatim të VKM Nr.248 datë 10.04.1998 "Për miratimin e Planit Kontabël Publik të Organeve të Pushtetit Lokal, institucioneve qendrore e lokale dhe njësive që varen prej tyre" i ndryshuar, Udhëzimeve të Ministrisë së Financave Nr.14 datë 28.12.2006 dhe Nr. 26 datë 27.12.2007 "Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare", të ndryshuar , Udhëzimi i Ministrit të Financave Nr.33 datë 28.12.2014 "Për procedurat e mbylljes vjetore të buxhetit për vitin 2015" për vitet 2015 dhe 2016 janë përgatitur pasqyrat financiare brenda afatit të parashikuar. Janë dorëzuar dhe vulosur në Degën e Thesarit Tiranë dhe Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, duke u pranuar pa vërejtje.



**6- Auditim mbi menaxhimin e aktiveve
Inventarët**

Në zbatim të Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.30 datë 27.12.2011 “ Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” janë ngritur komisionet me urdhërata përkatës për kryerjen e inventarit të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara dhe të patrupëzuara.

Janë ngritur komisionet për vitin 2015 sipas Urdhrit të Drejtorit të APAAL Nr.144 datë 15.12.2015 “Për inventarizimin fizik dhe vlerësimin e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara dhe të patrupëzuara në APAAL” dhe për vitin 2016 Urdhrit të Drejtorit të APAAL Nr.105 datë 07.12.2016 “Për inventarizimin fizik dhe vlerësimin e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara dhe të patrupëzuara në APAAL”. Fletët e inventarit janë të firmosur nga Komisioni dhe personi përgjegjës.

Në përmbledhëset e inventarit, vlerave aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara dhe të patrupëzuara është e njëjtë me shumen për çdo llogari ekonomike që është e pasqyruar në bilanc.

GRUPI I AUDITIMIT

Merita TERSHANA
Jeton SHEHU
Vjollca HAXHIU

[Handwritten signatures in blue ink]

